

## Tirana/ Sponsoret paguajne rrogat e lojtareve

nga AlbaniaSoccer

E mërkurë, 16 Tetor 2013 20:29

---



Tirana e halleve te shumta ka gjetur qetesine me afrimin e sponsoreve qe Bashkia ka gjetur para dy muajsh. Skuadra eshte paguar edhe per rrogen e dyte. Kete lajm e bejne te ditur futbollistet bardheblu qe prisnin me padurim te shikonin korrektesine e sponsoreve qe kane mbajtur fjalen. Tirana tani rrezikon seriozisht mbijetesen mes me te mirave te kampionatit ndaj skuadres i duhet te gjej forca per tu ringritur ne ndeshjet e ardhshme nese nuk duan te fundosen edhe me shume ne fundin e tabelës.